

Modeli ekonomik dhe politik që i imponohet Shqipërisë

Bëjmë këtë video për të kontribuar në përhapjen e një ligjërate demokratike dhe të vërtetë në realitetin shqiptar.

Shpresojmë që të pasohemi dhe nga të tjerë që duan të kontribuojnë për daljen nga ky banalitet funksional vetëm për kastën dhe privilegjet e saj. Shpresojmë të përhapim një kritikë të thellë ndaj këtij sistemi, duke dalë nga pseudokritika organizuar nga qarku mediatik dhe tellallet e këtij sistemi. Vazhdimi i status quo kërkon që e gjithë kritika të përqendrohet tek fytyrat e kastës dhe jo tek llogjika që mban këtë sistem në këmbë.

Kjo video do të pasohet nga të tjera video ku të trajtojmë më gjerësisht problemet e rënda të vendit, përgjegjësit direktë dhe të fshehur por mbi të gjitha rrugëdaljen nga ky kurth ekonomik dhe politik.

Fillojmë duke thënë se ajo çfarë po ndodh në Shqipëri, nuk është banale dhe e rastësishme por pjesë e një vizioni antidemokratik, kundër popujve dhe të drejtave të tyre. Shqipëria nuk është më një vend i izoluar dhe nuk do jetë më kurrë i tillë. Shqipëria është tashmë pjesë e një procesi si njihet me emrin globalizem që shtrin efektet e tij kudo edhe pse të fshehura me kujdes.

Reformat politike dhe ekonomike që i imponohen Shqipërisë janë pjesë e këtij vizioni dhe politikanet tanë janë kuklla të vetedishme dhe bashkepunuese me lobet që punojnë kundër interesave të popujve dhe të drejtave njerëzore. Prandaj duhet të shtrijmë debatin se cili është interesi i Shqipërisë. Me të kuptuar këtë interes kombëtar, largimi i këtyre kukllave është thejshet çështje kohe!

Shqiptarët me rënien e regjimit gjakatar enverist kërkuan me zgjuarsin "Liri-Demokraci". Pra të drejta dhe liri, por dhe një shtet social dhe ekonomi të zhvilluar në të mirë të të gjithëve që ti garantoje këto liri.

Por fati ynë i keq përkonte me ndryshimin e kursit që Perëndimi kishte ndërmarrë ndërkohë dhe fundi i komunizmit rrezoi dhe pengesën e fundit që deri atë kohe kishte frenuar elitat kapitaliste në dem të popujve.

(Pra Elitat financiare u cilruan nga çdo alternative që mund të kufizonte pushtetin e tyre duke krijuar një diktaturë të re, një diktaturë ekonomike përmes teorisë së sundimit të mendafshit dhe oponencës së kontrolluar)

Për dekada Perëndimi, pas luftës botërore, ishte dakordësuar që kapitalizmi duhet të mbahej nën kontroll prej demokracive në mënyrë që mos të shkatërronte bashkëjetesën paqësore mes individëve dhe mes popujve. Por dhe që popujt e tyre mos të shihnin me dëshirë komunizmin sovjetik. Një rrugë e ndermjetme, ku pabarazia ekonomike mos të ishte aq e lartë sa të minonte barazimin politik të çdo qytetari.

(Një sistem ku publikja dhe privatja nuk përmbysin njëra-tjetern por qëndrojnë në harmoni)

Pra liberalizmi të qëndronte bashkë me demokracinë si komplementarë të njëri-tjetrit. Pasi nuk ka demokraci pa liri të individit (si eksperimentuam nën diktaturën komuniste) por nuk mund të ketë as liri nëse ato nuk mbrohen prej vetë qytetarëve në një sistem demokratik të vërtetë. Si pasojë e kësaj martese të lumtur, në Perëndim lulëzoi mirëqenia e përhapur si dhe shtimi i të drejtave të Njeriut, të punëtorit, krijimi i një shtrese të mesme, kushte dhe shërbime publike për të gjithë qytetarët.

Konstitucionalizmi modern, pra njohu lirinë e individit në themel të tij por gjithashtu dhe demokracinë për të kufizuar dhe mbajtur nën kontroll abuzimin me lirinë, njohu pronën private, iniciativën e lirë dhe tregun, por gjithashtu dhe

ndërhyrjen publike që këto të drejta të ishin të aksesueshme për të gjithë dhe mos të rrezikonin të mirën e përgjithshme, njohu konkurrencën por dhe solidaritetin mes qytetarëve. Pra Shteti, demokracia dhe tregu qëndronin në një trinom të baraspeshuar.

Edhe në planin ndërkombëtar, u adoptuan këto teori ekonomike të ekonomistit të famshëm Keynes, që praninin ndërhyrjen shtetërore ndaj deformimeve të tregut si dhe një solidaritet mes ekonomive të shteteve të ndryshme me kapacitete të ndryshme prodhimi. Për këtë qëllim u krijuan marrëveshjet e Bretton Woods, FMN dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë.

Me pak fjalë, kudo lulëzoi një ekonomi progresi, lulëzoi demokracia, dhe një pushtet gjithmonë e më i madh i qytetarëve për të vendosur fatet e vendit. Kapitalizmi mori një fytyrë humane, fitimet më të mëdha ndaheshin në bazë të punës sesa kapitalit, dhe normat e interesit ndaj kapitalit po binin kudo dhe bashkë me të pesha e kapitalistëve të mëdhenj. Kjo rudhje e pushtetit të kapitalit të madh nuk tolerohej dot prej grupeve financiare dhe elitave.

Kështu që në vitet "70 fillon dhe ndryshimi i kursit botëror.

Braktiset teoria e Keynes dhe kudo nëpër universitetet dhe mediat pronë e kapitalit, pompohen idetë e neoliberalizmit, bazuar tek Hayek dhe Friedman. Djemt e Cikagos

Më shumë se një teori shkencore, këto janë thjesht dogma që qëndorjnë në këmbë vetëm me lojra iluzionesh, të cilat do i prekim një nga një në videot në vazhdim. Merremi këtu me efektet që këto teori prodhuan kudo në Perëndim dhe u adoptuan në Shqipëri pas viteve "90.

Politisht këto reforma quhen "Washington Consensus" dhe promotorë të saj u bënë pikërisht Reagan dhe Thatcher.

Shprehja e famshme e Thatcher, që nuk ka shoqëri por vetëm individë. Kërkohej rikthimi tek liria e plotë e tregut që mos të kontrollohej më nga shtetet por nga organizma ndërkombëtarë jashtë cdo kontrolli demokratik. I ashtëquajtur "deregulation".

Ndalohet ndërhyrja e shteteve në ekonominë dhe financat e tyre kombëtare, duke hequr dorë nga shërbimet publike. Filluan të privatizohesh cdo sektor publik, të drejtat e fituara ndër dekada, duke filluar nga ajo e punës. Në atë që njihet me eufemizëm si "fleksibiliteti" i punës. Anullohen kontratat kolektive të punës dhe garancitë e tjera si dhe defunksionalizohen sindakatat tani jo me të nevojshme.

Popujt nuk do i praninin lehtësisht këto reforma, kështu që sulmi u përqendrua kryesisht në mediat main stream, që kritikonin politikanët e korruptuar, dhe kështu ulej rezistenca popullore ndaj privatizimeve si zgjidhje për gjithcka.

Kultura individualiste dhe konsumeriste nuk pompohet vetëm nga mediat, por dhe nga qarku akademik që ushqehet me projekte dhe fonde prej elitave financiare. Kudo artikulohehin ide neoliberaliste kundër demokracive si të paafta për erë e re globale.

Komisioni trilateral në 1975 del me një deklaratë të hapur kundër demokracive në favor të qeverisjes globale nëpërmjet elitave financiare. Kudo reformat paraqiteshin si natyrore si të pashmangshme sepse kështu i kërkon Europa apo Tregu.

Pra dhe vetë Europa ndryshon kursin, duke përaçfuar teresisht idetë e Hayekut për ndërtimin e saj prej teknokratëve dhe jo nëpërmjet qytetarëve dhe popujve. Parlamenti evropian ishte një parlament që nuk vendos për asgjë si një mjek që nuk operon dot. Vendimet merren gjithmonë e me shumë prej teknokrateve në dhoma të errëta. Larg kontrollit demokratik dhe parlamenteve kombëtare. Edhe Euro është pjesë e këtij projekti politik, ku tashme Europa nuk flet me

për te drejta sociale dhe ekonomike, por përdor vetëm gjuhë financiare, austerity, spread etj. Popujt evropiane refuzuan kurmunden këtë projekt, me rrezimin e kushtetutes evropaine, nga refrendumi francez, hollandez apo irlandez. Kështu që elitat financiare që kanë marrë në kontroll BE vendosën të shmangin popujt duke bërë traktatën e Lisbonës, që populli e kishte hedhur poshtë me refrendum. Injorimin që BE bëri me popullin grek dhe francez nuk mund ta bënte dot me popullin anglez që vendosi të vendoste vetë fatet e tij.

Levizjet e reja progresiste në Europë (si 5 stelle, Podemos, Die 25 etj) kërkojnë demokratizimin e Europës së re në mënyrë që mos të fuqizohen levizjet populiste naziste apo totalitare si kundërpergjigje ndaj kësaj ere antidemokratike si kishte ndodhur me kapitalizmin pa frenë në vitet 30 të shekullit të kaluar.

Por i rikthehem disa prej politikave që u ndermorrën prej Washington Consensus:

Ndërtimi i këtij globalizmi financiar nuk mund të realizohej nëse nuk gëtohet sovraniteti i shteteve dhe bashkë me të demokracite, sepse demokracia funksionon brenda një shteti pasi nuk ka një popull ndërkombëtar planetar dhe çdo politikë publike vendoset dhe kontrollohet me konsensusin demokratik të qytetarëve të atij shteti.

Kudo u imponuan politikat e liberalizmit të kapitalit jashtë territorit kombëtar edhe pse pasuria prodhohej aty. Shtetet kështu humbasin kështu kontrollin kryesor në politikat publike.

U kufizua sovraniteti monetar. Bankat Qendrore kombëtare u privatizuan dhe u ndanë prej ministrisë së thesarit dhe kontrollit demokratik të parlamenteve. Tani shtetet duhet të marrin para nga bankat private për qëllim të interesit atë që dikur e prisnin duke nxjerrë prodhimin vendas. Objektivi i bankave u bë vetëm "ruajtja e çmimeve" si reciton nëni 11 i ligjit bankës shqiptare dhe jo me punësimin e përgjithshëm dhe zhvillimin e vendit si kërkonte teoria ekonomike keyneziane. Borsat publike fillojnë të shtohen dhe ndërkombëtarizohen, duke e ekspozuar tashmë ekonominë kombëtare ndaj spekulatorëve ndërkombëtarë të interesuar për falimentimin e shteteve. Qeveritë nuk kanë më në dorë asnjë instrument dhe detyohen të ndjekin orëkset e tregjeve duke shitur dhe privatizuar çdo gjë që është pasuri kombëtare. Ekonomitë e shteteve janë nën vlerësimin abuziv të disa agjencive si Standard & Poor's pa asnjë kontroll demokratik që vë në pikat shteteve si ndërmarrje biznesi që edhe mund të falimentojnë por shteti është entitet juridik i domosdoshëm dhe si i tillë nuk mund të falimentojë kurrë!

Heqja dorë prej ligjit Glass-Steagall, që ndante bankat tregtare ndaj atyre financiare, duke mos lejuar rrezikimin e depozitave të qytetarëve dhe duke i parë bankat të interesuara për zhvillimin e territorit ku gjendeshin, pra si agjente të zhvillimit të territorit. Tashmë me heqjen e këtij ligji, bankat filluan financën kreative duke mos kredituar me proceset prodhuese por në emetimin e titujve financiarë. Kriza e titujve toksikë në SHBA e në Europë është dëshmi i gjallë i këtij procesi që ka dalë jashtë çdo kontrolli duke bërë që sot baza monetare të jetë 60fish më shumë se sa e gjithë pasuria reale e planetit. Heqja dorë prej dollarit i tërëzuar me vlerën e arit lejoi dopimin e ekonomisë amerikane të konsumonte jashtë mundësive të saja dhe kjo peshe tani është e paperballueshme dhe shumë shtete të tjera nuk duan të mbajnë mbi shpinë këtë barë. Prodhimi pa fund të dollareve nga FED që nuk është bankë publike por në zotërim të bankave private, nuk mund të mbahet gjithë kohën me forcën e armëve si ka ndodhur deri tani me petrodollarin. Komuniteti ndërkombëtar ka filluar të refuzojë këtë imponim të SHBA dhe kjo po sjell ferkime në shkallë planetare me ekonomi të mëdha si Kina, Rusia, India, Brazili, Afrika e Jugut etj që kanë vendosur të krijojnë organizmat e tyre financiarë ndërkombëtarë.

Në summitin e G7 në 1979 Tokyo, u vendos që secili shtet të shihet të barazonte vetë bilancën e pagesave. Thyhet ai solidaritet mes shteteve që ekzistonte deri atëherë. Dmth kur një shtet kishte dizavanc tregtar, pra importonte më shumë sesa eksportonte, shtetet e forta forconin monedhën e tyre për të frenuar eksportet dhe shtetet e dobëta zhvlerësonin monedhën për të ndihmuar eksportet. Kjo bëhej nga vetë bankat qendrore të shteteve që ishin demokratike dmth kontrolloheshin nga parlamentet dhe ministritë e financave. Shteti emetonte obligacione me interesa të ulëta ose emetonte para për të stimuluar rritjen e brendshme.

Pas G7 të Tokyos, ky model u braktis dhe u imponoi shteteve që të afronin kapital nga jashtë më norma interesi të larta. Por kjo spirale negative forconte akoma më shumë ekonomitë e forta dhe dobësonte akoma më shumë ato të dobëta, që tani nuk mund të bënin dot më investime në teknologji për t'iu afruar ekonomive të forta.

Si shprehet nobelisti Stiglitz, Krugman e të tjerë ekonomiste nderkombetare, ky globalizim i eger shkon në dem te ekonomive të vogla, të cilat nuk mund të konkurrojnë dhe lehtësisht kthehen në ekonomi importi si fatkeqesisht është kthyer Shqipëria. Jo rastesisht, ato ekonomi që janë zhvilluar nuk kanë zbatuar dogmat neoliberale. Madje dhe vetë SHBA, Anglia dhe vetë BE zbatojnë masa të dyfishta, kundër ekonomise se lire si shprehet në librin e famshëm “bad samarritans” ekonomisti Ha-Joon Chang.

Keto reforma ekonomike kanë pasqyrimin e tyre në reformat politike si: perqendrimin e pushtetit ekonomik, financiar e mediatic gjithmone e në më pak duar. Demokracia fillon dhe lincohet nga të gjithë në favor të një vizioni elitist. Partitë kthehen në vegla të njëshit dhe një pjesë oligarkike që emerojnë njeri tjetrin në mënyrë të ngjashme me nomenklaturën komuniste. Parlamentet humbasin vendimmarrjen dhe zgjerohet roli i ekzekutivit apo agjencive të pavarura prej parlamentit. Referendumet, nismat ligjvënese popullore dhe instrumenta të tjerë kontrolli të qytetareve ndaj makines shtetërore cmontohen një nga një.

Konflikti nga vertikal kthehet në horizontal, ku qytetarët percahen dhe konfliktohen përdite në formë të ndryshme, por pa organizuar dot një rezistencë efektive ndaj elitave në pushtet.

Korrupsioni dhe shantazhimi kthehet në instrument nderkombetar falë parajsave fiskale, ku elitat emerojnë dhe shantazhojnë cilido që aspiron të hyjë në pushtet.

Kudo cmontohen të drejtat reale dhe premtohen vetëm liri potenciale. Kudo sponsorizohet zhdukja e identiteteve të popujve që të bredhin si endacake pa patur mundësi që të organizohen për një projekt të përbashkët.

Fantazmat e luftes dhe terrorizmit i mbivendosen pasigurisë për vendet e punës, për pensionet për shërbime publike, për shkollën etj. Destabilizmi konstant i njeriut dhe i shoqërive të pamundëson për të parë kuadrin e përgjithshëm dhe të harxhosh energji vetëm për veten tënde me shpresën se mund të dalësh edhe vetëm në një sistem që punon kundër teje.

Ajo çfarë ka ndodhur në Shqipëri (përmarrja e demokracisë, korrupsioni sistematik, deindustrializimi, terapia shock, transformimi në ekonomi importi, privatizimet e egra, dorezimi i sektorëve strategjicë të huajve, kontrolli i medias, shoqërisë civile, sindikatave, akademisë etj) po ndodh dhe në vendet e tjera por shumë popuj po organizojnë një rezistencë të efektshme në lëvizje politike, intelektuale kulturore etj.

Ajo çfarë duhet të bëjmë dhe në si shqiptarë, si pjesë vitale e kontinentit evropian, është të sinkronizohemi me betejat e popujve evropiane, për demokratizimin e shoqërive dhe insatimin e demokracive të vërteta si të vetmet garante për paqen, drejtësinë dhe begatë në mes popujve.

Zgjidhja nuk është asnjehere pas, të rikthehemi në izolimin enverist, në feudalizmin zogist apo atë otoman. Zgjidhja është vetëm përpara duke nxjerrë mesazhe nga e kaluara dhe përparësi një të ardhme të begatë, jashtë ideologjive dhe pro ideve

qe vihen ne jete dhe realizohen nga vete qytetaret pavarsisht bindjeve qe kane. Ate qe kerkon Habermas, pra nje demokraci pjesemarres, ku zgjidhjet jepen me ane bashkebisedimi demokratik me ane te institucioneve qe formohen dhe kontrollohen vazhdimisht prej qytetareve. Per te cberë antireformat e ketyre 26 viteve dhe per te realizuar reformat ne dobi te interesit kombetar, kemi nevojë qe vendimmarrja te kaloje nga partite, lobet, ambasadoret drejt qytetareve.

Shpresojme qe ne videot e tjera, te shpjegojme me hollesisht vizionin tone shqipon, te hartuar prej kohesh ne projektin SOS- qe e gjeni lehtesisht online ne Webin tone.

Ju falenderoj